



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE  
KËSHILLI DREJTUES**

**VENDIM QARKULLUES**

**Nr. 4, datë 09.03.2026**

**PËR  
MIRATIMIN E “PASQYRAVE FINANCIARE TË  
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2025”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 7, pika 2 dhe 3, të nenit 52 pika 1, shkronja “l” dhe nenit 62, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “c”, të nenit 7, pika 6, të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 6/1, shkronja “e” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 10, pika 6, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e “Pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2025”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi qarkullues.
2. Ngarkohet Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për dërgimin e pasqyrave financiare të audituara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Autoritetin Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.





3. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve për zbatimin e këtij vendimi qarkullues.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi qarkullues në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim qarkullues hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Kryetar

Shqipe Malaj

Sekretare

